



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

**“NDËRTIM I INFRASTRUKTURËS KËRKIMORE – SHKENCORE PËR ANALIZËN E
ÇRREGULLIMEVE TË SISTEMIT VESTIBULAR”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

33100000-1-Pajisje mjekësore

REF-55026-07-16-2025

VLERA E FONDIT LIMIT:

12,383,666.67 (dymbëdhjetë milion e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**

Referuar shkresës me Nr. 1480., Prot datë 26.06.2025, bashkëlidhur shkresës dhe specifikimet teknike me miratimin nga AKKSHI, ardhur nga drejtuesi i projektit me lëndë: “*Rishikim i propozimit mbi specifikimet teknike, projekti: “Ndërtim i infrastrukturës kërkimore – shkencore për analizën e çrregullimeve të sistemit vestibular”*”, është kërkuar blerja e pajisjeve sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga drejtuesi i projektit .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.1.1, 2.2 të “Kapaciteti Teknik” kriteri 2.3.5, 2.3.6, 2.3.8 janë vendosur nga Specialistet e SP,DSHM,UMT ndërsa kriteret 2.3.2, 2.3.3 2.3.4, 2.3.6 dhe 2.3.7 të “Kapacitetit Teknik” si dhe argumentimi i specifikimeve teknike janë vendosur dhe argumentuar nga Specialisti i Fushës, drejtues i projektit i cili është Prof.Dr. i Asoc, me përmbajtjen e kriterëve si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 82 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.1.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023 dhe 2024) ku vlera mesatare e tyre të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës së shpallur.**

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur

Argumentimi: Ky kriter (pika a), është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës; në pikën 1

dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara më poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qënë se kjo procedurë prokurimi bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qënë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;** si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit të kontratës së shpallur dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ne te cilin gjejmë te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar", në të cilën është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar", dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj

është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajtimit të duhur, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofruara, ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike për artikujt e kërkuar. Në katalogë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet, sipas modelit të deklaruar. (Katalogu duhet të ngarkohet në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit. Katalogët të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar (për të vërtetuar njehësimin me origjinalin).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim ose marrëveshje bashkëpunimi nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet e ofruara ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofertim të pajisjeve objekt i kësaj procedure. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si telefon, faks, e-mail, website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e pajisjeve. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në

marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.3 Operatori ekonomik për artikujt mjekësor duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit deri në ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 8, 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” i përditësuar i cili rregullon klasifikimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e tyre për sigurinë dhe cilësinë në përdorim. Sistemi Vestibulografik përdoret për diagnostikim të specializuar të sistemit të ekuilibrit dhe të funksioneve neurologjike të lidhura me veshin e brendshëm dhe tru. Ndërvepron në mënyrë direkte me pacientin, duke prodhuar stimuj fizikë (lëvizje, rrotullim) dhe duke mbledhur të dhëna për interpretim klinik. Kërkohet për sigurinë e pajisjes dhe përgjegjësinë ligjore ndaj pacientit dhe përdoruesit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën për periudhën e garancisë së pajisjeve, duke përfshirë zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale, si dhe të gjitha shërbimet periodike parandaluese që parashikon prodhuesi brenda periudhës së garancisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër garancinë e mallrave objekt prokurimit në përputhje me garancinë e pajisjeve. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet riparimi apo zvendësimi i tyre pa pagesë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ISO 9001:2015, ose ekuivalente, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të

Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të artikujve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP i ndryshuar, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është kërkuar kjo çertifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Certifikimi **ISO 9001:2015 është** standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel nderkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo çertifikatë i ofron siguri AK që OE ofrojnë produkte sipas cilësisë së kërkuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjet e kërkuara sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i produktit	Kompania prodhuese	Vendi i origjinës	Emërtimi i katalogut/brosurës së produktit	Numri i faqeve ku tregohen specifikimet	Certifikimet përkatëse të produktit (Certifikatë konformiteti sipas direktivës CE / FDA ose ekuivalente)
1						
2						
Etj.						

Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e certifikimeve përkatëse të produktit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1, të nenit 36, të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në të cilën është e përcaktuar se: 1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për rpersonat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2, të nenit 40 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “*Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*”, i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar*”, ku përcaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Ne këtë kontekst, do të bëhet e mundur verifikimi më i saktë i specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara, origjina, konformiteti, me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) inxhinier të fushës (inxhinier biomedical/elektronik/elektrik/informatik ose fusha të ngjashme), në stafin e vet ose me kontratë shërbimi të certifikuar /trajnuar për instalim dhe servis të pajisjeve objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave të trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomikë do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 te DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5/ b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar*” ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar, të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, duke garantuar instalimin e pajisjeve dhe realizimin e servisit të tyre gjatë gjithë periudhës së garancisë.

Natyra e ndërlikuar teknologjike e pajisjeve vestibulare

Pajisjet e sistemit vestibular janë teknologji të specializuara mjekësore, të cilat përfshijnë sensorë të ndjeshëm, algoritme për përpunim sinjali, kamera infra të kuqe, matës të lëvizjeve të kokës dhe trupit, dhe softuer të integruar. Këto kërkojnë njohuri të thelluara teknike për:

- Instalimin korrekt dhe kalibrimin,

- Konfigurimin sipas protokolleve mjekësore,
- Integrimin me sisteme të tjera (kompjuterë, servera, EMR, etj.).

Vetëm një inxhinier i fushës përkatëse dhe i trajnuar mund të garantojë që këto procese të realizohen sipas standardeve.

Siguria dhe saktësia e diagnostikimit

Përdorimi i pasaktë apo konfigurimi jo i duhur i pajisjeve vestibulare mund të:

- Çojë në diagnoza të gabuara, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në trajtimin e pacientëve me çrregullime të ekuilibrit,
- Rrezikojë sigurinë e pacientit, veçanërisht gjatë testeve të ekuilibrit ose nystagmografisë.

Prania e një specialisti të certifikuar është e domosdoshme për të garantuar saktësinë e sistemit dhe minimizuar rreziqet klinike.

Përmbushja e standardeve të prokurimit publik dhe të mirëmbajtjes pas marrjes në dorëzim të mallit:

- Shërbim profesional pas marrjes së mallit (after-sales service),
- Mbështetje teknike në vend, që të mos ketë vonesa në rast defekti ose nevojë për ndërhyrje.

Kjo mundësohet vetëm nëse operatori ka të punësuar një person të kualifikuar, jo thjesht distributor komercial.

Mbikëqyrja efektive e mirëmbajtjes dhe funksionimit në kohë reale

Vetëm një inxhinier i dedikuar dhe i punësuar nga operatori ekonomik mund të:

- Ndërhyjë në kohë reale në rast defekti ose avarie,
- Mbikëqyrë funksionimin dhe mirëmbajtjen periodike,
- Ofrojë mbështetje të menjëhershme gjatë instalimit dhe pas tij

Një operator ekonomik me staf teknik të trajnuar:

- Ka inxhinierë të certifikuar për pajisjet specifike,
- Mund të ofrojë instalim të sigurt, mirëmbajtje dhe ndërhyrje teknike, duke respektuar kërkesat e prodhuesit dhe standardet mjekësore,
- Është në gjendje të trajtojë stafin përdorues të institucionit shëndetësor.

Kjo është arsyeja pse në shumë raste në prokurimet për pajisje mjekësore kërkohet qartë që operatori ekonomik të mos jetë thjesht një distributor komercial, por të ketë edhe kapacitet teknik të dokumentuar për të garantuar funksionimin dhe mbështetjen e pajisjes gjatë gjithë ciklit të saj të përdorimit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të konfirmoj që pajisjet e ofruara janë të reja dhe origjinale dhe do të realizohet furnizimi brenda afateve të përcaktuara në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se mallrat që do të furnizohen janë të reja (për të shmangur dorëzimin e produkteve të përdorura) si dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara për secilën pajisje.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 9) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VENDIMIN Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, „ duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Referuar kërkesës me Nr.1480., Prot datë 26.06.2025 me lëndë: **“Ndërtim i infrastrukturës kërkimore – shkencore për analizën e çrregullimeve të sistemit vestibular”**, nga Drejtuesi i projektit janë përcaktuar specifikimet teknike sipas shtojcës 5 të Dokumentave Standarde të Tenderit. Kur përdoret emri markës pranohet ose ekuivalenti me të.

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me pjesën teknike janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, bazuar në funksionalitetin që duhet të ketë pajisja si më poshtë:

Te pajisja VNG- VGN goggle me montim lateral ose frontal, me kamera wireless me rezolucion jo më pak se (640*480) i mjaftueshëm për imazhe të detajuara. Këndi i pamjes: Rreth 110° horizontal dhe 60° vertikal për të siguruar regjistrimin e plotë të lëvizjeve të syrit 120 frame/sec ose më shumë. (Janë

vendosur si specifikime të mjaftueshme sepse sigurojnë pamje (imazhe të qarta), të detajuara dhe regjistrojnë pamjet e syrit fraksione sekondash. Kablli minimumi 7 m i gjatë ose ekuivalent i përshtatet dhe hapësirës së ambientit (labororit) ku do vendoset që të jetë lehtësisht i aksesueshëm.

Te pajisja V Hit- . Rezolucioni i kapjes minimalisht 1456*1088 pixels, rezolucioni i videos mjaftueshëm për imazhe të detajuara (është vendosur pasi ky rezolucion është i mjaftueshëm për të pasur imazhe të qarta, të dukshme).

Karrigia rrotulluese - Këndet 0–90° dhe lëvizja e kokës ose trupit në këto pozicione përdoren për:

1. Të stimuluar kanalet e ndryshme të sistemit vestibular, që janë të vendosura në orientime të ndryshme (horizontal, posterior dhe anterior).
2. Të provokuar ose matur reagimin vestibular në pozicione specifike, që ndihmojnë në diagnostikimin e çrregullimeve.
3. Sigurinë dhe standardizimin e procedurave — këndet 0–90° janë të matshme dhe të përsëritshme, gjë që ndihmon në vlerësime objektive.

Pse përdoren këto përmasa:

1. 0° (pozicioni neutral) është pozicioni fillestar — shpesh trupi dhe koka janë në linjë të drejtë, pa asnjë përkulje.
2. 90° përdoret sepse:
 - Kur e kthen kokën ose trupin në këtë kënd, i vendos kanalet e brendshme të veshit (semicircular canals) në pozicion që ndjeshëm aktivizojnë receptorët vestibularë.
 - Është këndi ideal për të provokuar simptoma të vertigos në rastet kur grimcat e kalciumit (otolitët) kanë hyrë në kanalet vestibulare.

Në manovrën Dix-Hallpike, pacienti ulet në shtrat, koka i kthehet 45°, pastaj ai shtrihet me kokën të përkulur 20–30° poshtë nivelit të shtratit (kjo mund të shihet si pjesë e këtyre këndeve 0–90°), për të stimuluar kanalin posterior.

Koka e shtratit hiqet , për të lejuar:

- Shtrirjen e kokës poshtë horizontales, që është e domosdoshme për disa manovra (si Dix-Hallpike).
- Lëvizje më të lirshme dhe të kontrolluara, pa pengesë mekanike nga struktura e shtratit.

këndet 30° janë thelbësore për shkak të pozicionit të kanaleve të brendshme të veshit, konkretisht kanalit horizontal (lateral semicircular canal).

30° për provat kalorike

Kur bën provën kalorike (e cila përfshin futjen e ujit të ftohtë apo të ngrohtë në vesh për të stimuluar sistemin vestibular), duhet që kanali horizontal të jetë në pozicionin më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve

të temperaturës.

Kanali horizontal nuk është në të vërtetë horizontal kur njeriu është në pozicion shtrirë!

Ai qëndron rreth 30° mbi horizontin kur njeriu është ulur ose në këmbë.

□ Çfarë bëjmë atëherë?

Kur pacienti shtrihet për provën kalorike, i ngre kokën 30° nga pozicioni horizontal.

Kështu, kanali horizontal bëhet paralel me dyshtimin. Ky pozicion lejon që stimuli termik (i ftohtë ose i ngrohtë) të krijojë rrjedhje të lëngut endolimfatik në atë kanal.

200°/s është kufiri fiziologjik i sistemit vestibulo-okular (VOR)

- Sistemi vestibular është përgjegjës për stabilizimin e shikimit gjatë lëvizjes së kokës.
- Kur stimulohet fort (si në provat kalorike), ai prodhon nystagmus me një komponent të ngadaltë (slow phase) dhe një të shpejtë (fast phase).
- Slow phase velocity (SPV) është ajo që matet si tregues i fuqisë së përgjigjes vestibulare.
- Në një sistem normal, SPV mund të arrijë 200°/s, por rrallë më shumë — mbi këtë vlerë, sistemi nuk e përballon dot më mirë stimulën.

200°/s është kufiri maksimal fiziologjik për provat jo-rotative

- Në testet si provat kalorike (stimulus termik), apo testet rotative të zakonshme, stimulohet vetëm një pjesë e sistemit vestibular.
- Stimulimi termik nuk është shumë i fortë krahasuar me manovrat më dinamike (si impulse test), por megjithatë arrin shpejtësi të larta në subjektë me sistem të paprekur.
- Për këtë arsye, shpejtësia prej 200°/s është konsideruar si kufi i sipërm normal fiziologjik.

Karrigia mund të përdorë kontrollerë industriale (PLC) ose softuer të dedikuar për të rregulluar lëvizjen. Këta komponentë zakonisht janë projektuar për tension standard 230V, për të shmangur përdorimin e transformatorëve apo rreziqeve nga furnizim jo i qëndrueshëm. Pajisjet mjekësore të certifikuar për përdorim në BE përdorin tension standard të rrjetit sipas rajonit. Në Europë: 230V / 50Hz është norma. Kjo ndihmon për të ruajtur pajisjen nga dëmtimet dhe për të garantuar që sistemi i ndjeshëm elektronik brenda karrigës të punojë pa gabime.

Për PC- Këto specifikime janë kërkesa minimale të një sistemi kompjuterik për të përputhur teknologjinë me një PCT Express card, në veçanti FireWire systems.

Express Card (FireWire systems only)

- Kjo kartë është përdorur për komunikim me pajisje që përdorin FireWire (për shembull, kamera profesionale, pajisje audio/video, etj.).
- FireWire ka kërkesa për shpejtësi të qëndrueshme të transferimit të të dhënave, prandaj hardueri duhet të jetë në nivel të caktuar për të përballuar këtë fluks pa ngadalësime.

USB port

- nevojitet për pajisje ndihmëse (si tastiera, maus, ose për konfigurim të kartës).
- FireWire kartela përdorin USB për energji ose konfigurim.

Intel i5 processor, min 2.2 GHz, Të paktën gjenerata 5

- Kjo tregon për një procesor modern që ka mjaftueshëm fuqi për të përpunuar në kohë reale të dhënat që vinë nga FireWire (audio/video me bitrate të lartë).
- Gjeneratat më të reja përfshijnë përmirësime në performancë dhe efikasitet energjetik, gjë që ndihmon në stabilitetin e sistemit gjatë përdorimit intensiv.

Minimalisht 4 cores (4 threads)

- Kërkohej për multitasking efikas: për shembull, një bërthamë merret me të dhënat që vinë nga pajisja FireWire, një tjetër me shfaqjen e imazhit, një tjetër me ruajtjen e të dhënave, etj.
- Procesorët me më pak bërthama do të bllokoheshin më lehtë ose do të sillnin vonesa.

Minimumi 8 GB RAM ose më shumë

- RAM-i është i nevojshëm për të mbajtur buffer-e të mëdha të të dhënave në memorie para se të ruhen ose përpunohen.
- Në video ose përpunim audio, shumë RAM do të thotë më pak ngarkesë për CPU dhe më shumë stabilitet.

Hard drive minimalisht 250 GB

- Videot e kapura përmes FireWire, sidomos në cilësi të lartë, zënë shumë hapësirë.
- Një minimum prej 250 GB është i arsyeshëm për projekte të vogla, por në praktikë, sa më shumë aq më mirë.

Display minimalisht 1366x768

- Ky është një rezolucion bazë që e bën të mundur shikimin e qartë të ndërfaqes së softuerit që përdor FireWire.
- Me rezolucione më të ulëta, ndërfaqja e përdoruesit nuk do të shfaqej siç duhet, veçanërisht për programe profesionale për video/audio.

Kartë grafike ose sistem që mbështet teknologjinë FireWire

- Një kartë grafike ndihmon për përpunimin e imazheve në kohë reale.
- Në shumë raste, softuerët që përdorin FireWire përfitojnë nga akselerimi grafik.
- Në mungesë të kartës grafike, kërkohen specifikime më të larta për CPU dhe RAM, prandaj është më efikase të kesh një GPU të dedikuar.

Të gjitha këto kërkesa kanë për qëllim të sigurojnë që:

- Pajisja FireWire të funksionojë siç duhet.

- Sistemi të përballojë të dhënat në kohë reale pa ngadalësim.
- Përdoruesi të ketë një përvojë të qëndrueshme dhe efikase në përdorimin e softuerëve profesionalë të lidhur me këtë teknologji.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Ndërtim i infrastrukturës kërkimore – shkencore për analizën e çrregullimeve të sistemit vestibular”**.

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

- Specifikimet teknike janë sipas kërkesës me Nr. 1480., Prot datë 26.06.2025, bashkëlidhur kërkesës dhe specifikimet teknike, ardhur nga drejtuesi i projektit me lëndë: **“Ndërtim i infrastrukturës kërkimore – shkencore për analizën e çrregullimeve të sistemit vestibular”**.

Sistem i Vestibulografrit (vestibulometrisë)				Kjo pajisje regjistron levizjet e syve te pacientit gjate një sere provash vestibulare. Përdoret për të vlerësuar në mënyre cilësore e sasiore funksionin e sistemit vestibular. Pajisjet pjesë e sistemit si më poshtë:
NR	PAJISJET	NJËSIA	SASIA	SPECIFIKIMET TEKNIKE
1	VNG	copë	1	Sistemi VNG duhet të krijojë mundësinë për të vlerësuar periferinë vestibulare dhe rrugët nervore vestibulare centrale. Për këtë arsye sistemi duhet të jetë në gjendje të ofrojë testet sa më poshtë: Video Frenzel, Nystagmus spontan, Gaze, Dix Hallpike, Positional, testet kalorike Bitermale, testet Optokinetike, Smooth Pursuit, Saccade, Step Rotation, Sinusoidal Harmonic Acceleration, Visual VOR. Me qëllim realizimin e testeve sa më lartë, në pajisje duhet të përfshihen: VGN goggle me montim lateral ose frontal, me kamera wireless me rezolucion jo më pak se (640*480) i mjaftueshëm për imazhe të detajuara. Këndi i pamjes: Rreth 110° horizontal dhe 60° vertikal për të siguruar regjistrimin e plotë të lëvizjeve të syrit 120 frame/sec ose më shumë. Lightbar digital Kablli minimumi 7 m i gjatë ose ekuivalent, sipas teknologjisë dhe funksioneve të nevojshme. Software e testeve Kontroll remote dhe/ose këmbë. Guida e sistemit e përfshirë Certifikatat dhe raportet e kalibrimit Interface USB
2	Sistemi V Hit	copë	1	Pajisje që përdor kamerën për të vlerësuar refleksin vestibule-okular (VOR) duke matur, regjistruar, shfaqur dhe analizuar reagimin e syve ndaj lëvizjeve të papritura të kokës. Rezolucioni i kapjes minimalisht 1456*1088 pixels, rezolucioni i videos mjaftueshëm për imazhe të detajuara. Të ofrojë mundësinë e kryerjes së testit pa vendosjen e goggle me qëllim analizimin e shpejtë dhe të thjeshtë të pacientëve, vecanërisht të moshave pediatrike. Interface USB2.0. Gjatësi e kabllit min 7 m i gjatë ose ekuivalent sipas teknologjisë dhe funksioneve të nevojshme. Softëare përkatës. Full HD kamera ose sipas teknologjisë së sistemit të ofruara. Guida e sistemit e përfshirë. Certifikatat dhe raportet e kalibrimit.
3	Karrigia rrotulluese	copë	1	Karrige që merr pozicione të ndryshme të nevojshme për Dix Hallpike dhe provat kalorike. Koka e shtratit që hiqet, këndet e lëvizjes 0-90°, 30° për provat kalorike. Koka e shtratit duhet të jetë në gjendje të përshtatet dhe të hiqet, si dhe karrigia të

				jetë e pajisur me rrip sigurie. Shpejtësia maksimale në vlerat kinetike duhet të jetë afërshisht 200o/s. Duhet të jetë e pajisur me buton ndalues për rastet e emergjencës. Furnizimi me energji elektrike 230 V/50 Hz
4	PC	copë	1	PCI Express card (Firewire® systems only). USB port Intel i5 processor, min 2.2 Ghz ose më shumë, jo më i vjetër se gjenerata e 5-të. Minimalisht 4 cores (4 threads). Minimumi 8 GB Ram ose më shumë. Hard drive minimalisht 250 GB space. Display minimalisht 1366x768 Kartë grafike. Ose PC dhe software me specifikimet teknike të përshtatshme me teknologjinë e sistemit që ofrohet
5	Sistemi i provave kalorike	copë	1	Sistem irrigimi për provat kalorike. Sistemi duhet të kryejë diagnostikimin termik/kalorik vestibular të pacientëve me problem të ekuilibrit duke përdorur fluks uji ose ajri të ftohtë dhe të ngrohtë, me temperaturë të konfigurueshme, indicator pulsues për sa kohë që temperature nuk është arritur ende.

Njësia e Prokurimit: